

V E N D I M

Nr. 826, datë 30.12.1998

PËR RRITJEN E PENSIONEVE

Në mbështetje të nenit 100, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e Ministrisë së Punës e Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Pensionet e caktuara sipas ligjit nr. 4171, datë 13.9.1966 dhe ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, me përjashtim të pensioneve të caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96 të ligjit 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” dhe të paragrafit të dytë,

të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998, ndryshohen si vijon:

“Pensionet e pleqërisë, pensionet e parakohshme, pensionet për merita të veçanta dhe pensionet për vjetërsi shërbimi rriten në masën 10 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare rriten në masën 15 për qind.”

2. Rritjen në masën e mësipërme e përfitojnë dhe pensionet që do të caktohen me datë fillimi deri më 31.3.1999, duke përfshirë edhe këtë datë.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar, me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim nuk mund të caktohen më pak se 4400 lekë në muaj. Pensioni maksimal mbetet 8000 lekë në muaj.

3. Shtesa mujore e përfituar nga vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 326, datë 21.6.1993 “Për kriteret e trajtimit të invalidëve të luftës kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, rritet në masën 10 për qind.

4. Pensionet e pleqërisë të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të dytë të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993 ndryshuar me ligjin nr.7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998, rriten në masën 10 për qind.

Pensionet e invaliditetit dhe pensionet familjare, të caktuara sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, si dhe pensionet e caktuara sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, rriten në masën 15 për qind.

Pensioni i plotë i pleqërisë, pensioni i plotë i invaliditetit dhe pensioni i plotë familjar që caktohen sipas paragrafit të parafundit të nenit 96, të ligjit 7703, datë 11.5.1993, si dhe

pensionet e caktuara sipas paragrafit të dytë, të nenit 12 të ligjit nr. 8392, datë 2.9.1998 “Për disa shtesa e ndryshime në ligjin nr.7703, datë 11.5.1993, ndryshuar me ligjin nr. 7932, datë 17.5.1995 dhe me ligjin nr. 8286, datë 16.2.1998 me datë fillimi nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi e në vazhdim, nuk mund të caktohen më pak se 1155 lekë në muaj.

5. Pensionet e caktuara sipas dekretit nr. 758, datë 1.2.1994 “Për një mbrojtje të veçantë të ushtarakut” rriten në masën 10 për qind.

6. Efektet financiare nga rritja e pensioneve llogariten në shumën 154.8 milionë lekë në muaj dhe të përballohen nga fondi i Sigurimeve Shoqërore të programuara në buxhetin e vitit 1999.

7. Për përballimin e volumit të punës për rritjen e pensioneve dhe për prodhimin e urdhër pagesave të reja, Instituti i Sigurimeve Shoqërore të përdorë 4.5 milionë lekë, të cilat të përballohen brenda buxhetit të shpenzimeve administrative të Institutit të Sigurimeve Shoqërore të vitit 1999.

8. Ngarkohen Instituti i Sigurimeve Shoqërore dhe Banka e Kursimeve për zbatimin e këtij vendimi dhe për nxjerrjen e udhëzimeve përkatëse në bazë dhe për zbatimin e tij. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe i shtrin efektet nga data 1.1.1999.

KRYEMINISTRI
Pandeli Majko